



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 119 dt. 11.12.2014

Në mbështetje të nenit 47, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.12.2014, pasi shqyrtoi relacionin teknik të paraqitur nga OST, i diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e kushtit të detyrueshëm të pikës 2 të Vendimit të KKR Nr. 34 dt.15.07.2014 ku citohet : “*Linjat dhe shtyllat të vendosen mbi 500 m larg nga objekti Kalaja e Borshit*”, si më poshtë:

Miratimin e kërkesës dhe relacionit teknik për ndërtimin e linjës 110 kV Babicë-Sarandë nga OST-ja për të mos ndryshuar trasenë e kësaj linje, për dy shtyllat që ndodhen pranë Kalasë së Borshit, përkatësisht 320 metra (pika më e afërt e linjës me kalanë) dhe 405 metra.

2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI